



Ekstremizmi i dhunshëm dhe sporti në Ballkanin Perëndimor

Autore: **Marija Gjoriq**, Eksperte e jashtme e RNR-së

Radicalisation Awareness Network

RANI 
Practitioners

Ekstremizmi i dhunshëm dhe sporti në Ballkanin Perëndimor

NJOFTIM LIGJOR

Ky dokument është përgatitur për Komisionin Evropian, por i njëjti pasqyron pikëpamjet vetëm të autorit, dhe Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për çfarëdo pasoje të mundshme që mund të gjenerohet nga ripërdorimi i këtij botimi. Më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian mund të gjeni në faqen e internetit (<http://www.europa.eu>)

Luksemburg: Zyra e publikimeve e Bashkimit Evropian, 2023

© Bashkimi Evropian, 2023



Politika e ripërdorimit të dokumenteve të Komisionit Evropian zbatohet me Vendimin e Komisionit 2011/833/BE të 12 dhjetorit 2011 për ripërdorimin e dokumenteve të Komisionit (Gazeta Zyrtare L 330, 14.12.2011, f. 39). Përveç nëse shënohet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti autorizohet sipas licencës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC-BY 4.0) (<https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>). Kjo do të thotë se përdorimi ose ripërdorimi lejohet me kusht që të përmendet autori dhe të tregohet çdo ndryshim.

Për çdo përdorim ose riprodhim të elementeve që nuk janë në pronësi të Bashkimit Evropian, leja mund të kërkohet drejtpërdrejt nga titullarët përkatës të të drejtave.

Hyrje

Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova* ⁽¹⁾, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) përfaqëson një rajon pas konfliktit ⁽²⁾ që përballlet me forma të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm. Aktualisht, Ballkani Perëndimor kryesisht përballlet me probleme të ekstremizmit islamik (EI) dhe ekstremizmit të krahut të djathtë (EKD). Midis viteve 2012 dhe 2016, më shumë se 1.000 persona nga Ballkani Perëndimor udhëtuan në fushat e betejës në Siri dhe Irak (Metodieva, 2021, fq. 2), shumica e të cilëve iu bashkuan organizatave terroriste (Daesh dhe Fronti Al-Nusra). Për momentin, kthimi i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) dhe i familjeve të tyre, duke përfshirë fëmijët dhe të miturit, nga zonat e luftës është një sfidë e madhe e sigurisë. Paralelisht me këtë çështje, në vitet e fundit është shënuar një rritje e EKD-së në Ballkanin Perëndimor, që është reflektim i një tendence më të gjerë globale. Gjeneruesit kryesorë të ringjalljes së saj janë kriza e emigrantëve dhe pandemia e KOVID-19 (Gjoriq & Klačar, pa datë).

Objektivi kryesor i këtij punimi është të ofrojë njohuri praktike se si ekstremistët në Ballkanin Perëndimor përdorin sportin për të lidhur aktorët ekstremistë, për të shpërndarë propagandë, si dhe për të rekrutuar dhe radikalizuar individë. Analiza bazohet në hulumtime në zyrë dhe intervista të detajuara. U organizuan 15 intervista të detajuara me anëtarë të sektorit të sigurisë, OJQ-ve, komunitetit akademik dhe aktorët e sportit në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Punimi është i strukturuar si më poshtë: pas një hyrjeje të shkurtër, dy seksione kryesore e përbëjnë thelbin analitik, e më pas vijnë përfundimet dhe rekomandimet. Nga të dy seksionet, i pari fokusohet në lidhjen midis ekstremizmit të dhunshëm të krahut të djathtë (EDhKD) dhe huliganëve të futbollit, duke marrë parasysh teknikat e rekrutimit, si dhe lidhjet midis huliganizmit dhe nacionalizmit, krimit të organizuar dhe politikës, ndërsa i dyti e trajton marrëdhënien ndërmjet EI-së dhe sportit.

Ekstremistët e dhunshëm përdorin metoda dhe mjete të ndryshme për të radikalizuar dhe rekrutuar të rinjtë (p.sh. video lojëra, rrjete sociale, muzikë dhe humor), e një prej tyre është edhe sporti.

Lidhja midis ekstremizmit të dhunshëm dhe sportit në Ballkanin Perëndimor ekziston dhe mund të shihet në dy mënyra:

1. sporti si mjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, një ide që ende nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm në praktikë në rajon; dhe

2. sporti si mjet politizimi dhe rekrutimi i të rinjve për t'iu bashkuar grupeve ekstremiste (kjo tendencë është bërë gjithnjë e më e fortë dhe mund të bëhet një çështje serioze e sigurisë për rajonin).

⁽¹⁾ Referenca duhet të kuptohet në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim për statusin e Kosovës.

⁽²⁾ I gjithë rajoni ishte i përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në luftërat e viteve të 1990-ta, gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë.

1. Ekstremizmi i dhunshëm i krahut të djathtë dhe huliganët e futbollit

Lidhja e drejtpërdrejtë mes sportit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor, deri më tani, ka qenë më e pranishme në futboll. Që nga vitet e 1980-ta kur "sporti jugosllav në atë kohë pasqyronte dobësinë e shtetit jugosllav" (Brentin, 2014, para. 4), e deri më sot, ai tani është bërë një instrument në duart e grupeve të ndryshme ekstremiste. Konkretisht, ky proces ka përfshirë krijimin e grupeve huligane të futbollit të motivuara kryesisht nga ideologjia e EKD-së (kryesisht në formën e nacionalizmit dhe, në një shkallë më të vogël, nazizmit). Në Ballkanin Perëndimor, janë identifikuar gjithsej 122 grupe tifozësh, nga të cilat 78 janë ultras dhe 21 kanë marrë pjesë në incidente huliganësh (Gjorgjeviq dhe Scaturro, 2022). Huliganizmi në Ballkanin Perëndimor është shumë i rrezikshëm sepse është një kombinim i disa fenomeneve të rëndësishme: pushtetit politik, krimit të organizuar dhe ekstremizmit (Gjoriq, 2012, fq. 139).

Përkufizime

Megjithëse shprehjet 'ultra' dhe 'huliganë' nuk janë reciprokisht ekskluzive dhe dallimi midis të dyjave është shpesh i paqartë, mund të vërehen disa dallime kryesore. Termi "ultras" zakonisht i referohet shoqatave të organizuara mirë të tifozëve të futbollit, të cilët në përgjithësi janë të lidhur ngushtë me një territor specifik, perspektivë politike dhe/ose një grup etnik. Në përgjithësi, dhuna nuk përfaqëson një objektiv në vetvete për "ultras"-it, edhe nëse ndonjëherë përfshihen në incidente të dhunshme. Përkundrazi, huliganët paraqesin një prirje të qartë drejt përfshirjes së rregullt dhe kolektive në episode të dhunshme brenda kornizës së konteksteve sportive. Marrë në përgjithësi, të gjithë huliganët janë "ultras", por jo të gjithë "ultras"-it janë huliganë.

1.1. Manifestimet e ekstremizmit të dhunshëm të krahut të djathtë të huliganët e futbollit

Lidhja mes huliganizmit të futbollit dhe EDhKD-së është më e theksuar në Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

Në **Serbi**, huliganizmi në futboll arriti kulmin gjatë luftërave në vitet e 1990-ta, kur vullnetarët për formacionet paraushtarake u rekrutuan nga radhët e grupeve të tifozëve⁽³⁾. Një karakteristikë specifike e huliganëve në Serbi është se ata ishin dhe mbeten instrument i politikës. Kjo u dëshmuua më së miri më 5 tetor të vitit 2000, kur të njëjtët huliganë që kishin mbështetur regjimin e Slobodan Millosheviqit morën pjesë në rrëzimin e tij. "Politizimi i huliganizmit" vazhdon edhe sot. Në vitin 2010, për shembull, rreth 6.000 huliganë u përleshën me policinë në përpjekjen e tyre për të prishur mbajtjen e "Paradës së Krenarisë" në Beograd, duke shkaktuar lëndime të më shumë se 100 personave⁽⁴⁾ dhe duke vandalizuar qytetin me një kosto të vlerësuar të dëmeve prej 1 milion eurosh⁽⁵⁾. Përveç lidhjeve mes huliganizmit dhe sferës së politikës, huliganët, në disa raste, janë shndërruar edhe në grupe të krimit të organizuar. Edhe pse ideologjia e tyre mbetet e ekstremit të krahut të djathtë, kjo është vetëm një fasadë për rekrutimin e të rinjve, ndërsa qëllimi i vërtetë është dobia (fitimi) fitimprurëse⁽⁶⁾. Dy grupet më me ndikim të huliganëve e kanë origjinën nga radhët e tifozëve të klubit të futbollit (KF) "Cërvena Zvezda" dhe KF "Partizan". Tifozët e Cërvena Zvezdës, të njohur si *Delije*, janë të ndarë në disa grupe, si *Djemtë e Beogradit*⁽⁷⁾, *Rif Raff*, *Hijene* (Hijenat), *Brigada* (Brigadat) dhe *Bez straha* (Pa frikë). Për momentin, ato janë në proces të rinovimit të gjeneratave; një duzinë liderësh (nga mosha 35 deri në 40 vjeç) i kontrollojnë tifozët e Cërvena Zvezdës⁽⁸⁾. Në vitin 2009, u paraqit një propozim për ndalimin e aktiviteteve të dhunshme dhe kriminale të 14 grupeve ekstremiste, tifozë të KF Partizanit, KF Cërvena Zvezdës dhe KF Radit nga Beogradi, por u

⁽³⁾ Shkalla e politizimit të sportit (veçanërisht futbollit) ilustron më së miri nga fakti se shumë studiues besojnë se shpërbërja e Jugosllavisë u njoftua në ndeshjen midis Cërvena Zvezdës dhe Dinamos në vitin 1991. Gjatë kësaj ngjarjeje, *Delije* (tifozët e Cërvena Zvezdës nga Serbia) u përleshën me *Bad Blue Boys* (tifozët e Dinamos nga Kroacia), në stadiumin Maksimir në Zagreb, kur parullat nacionaliste çuan në dhunë brutale.

⁽⁴⁾ Shumica e të plagosurve ishin policë.

⁽⁵⁾ Gordana Andriq dhe Bojana Barilovac, [Përfundojnë trazirat e Beogradit, Zyrtarët dënojnë dhunën](#), Balkan Insight, 10 tetor 2010.

⁽⁶⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 3.

⁽⁷⁾ Aktualisht grupi më dominues.

⁽⁸⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Serbi), Nr. 4.

refuzua për shkak të mungesës së parakushteve kushtetuese të nevojshme për kryerjen e procedurave të tilla përpara Gjykata Kushtetuese ⁽⁹⁾.

Në **Maqedoninë e Veriut**, ekstremizmi i dhunshëm në lojërat e futbollit është i lidhur me struktura të caktuara politike dhe kriminale ⁽¹⁰⁾. Në këtë vend, grupet e tifozëve filluan të organizohen në fund të viteve të 1980-ta. Grupi i parë i tifozëve u formua në vitin 1987 me emrin *Komiti* (Komitët), i cili mbështeti klubin e futbollit Vardar (Musliu, 2022, fq. 12). Një ndryshim i madh ndodhi në vitet e 1990-ta me shpërbërjen e Jugosllavisë. Gjatë asaj kohe, patriotizmi lokal u forcua dhe pothuajse çdo qytet kishte klubin e vet të futbollit. Përplasjet më të mëdha ndërmjet *Komitëve* dhe *Çkëmbarëve* (përkatësisht, tifozëve të KF Vardarit dhe KF Pelisterit) zhvillohen jo vetëm në futboll, por edhe në ndeshjet e basketbollit dhe hendbollit (Musliu, 2022, fq.13) ⁽¹¹⁾. Grupet e tifozëve maqedonas më me ndikim janë në kryeqytet, në Shkup, ku maqedonasit e përbëjnë shumicën etnike.

Bosnja dhe Hercegovina është shumë specifike për shkak të ndarjes së saj etnike ⁽¹²⁾ dhe kantonale, e cila reflektohet edhe në sport (d.t.th. në futboll). Në Bosnje dhe Hercegovinë, grupet Ultras përfaqësojnë një lloj kundërpeshimi ndaj strukturave politike të korruptuara, sepse "Ultrasit e portretizojnë veten si grupi i vetëm i rezistencës ndaj status quo-së" (Testa, 2020, fq. 29).

Në pjesë të tjera të Ballkanit Perëndimor, ekziston gjithashtu një lidhje midis huliganëve të futbollit dhe ekstremizmit të dhunshëm, vetëm se është më pak e theksuar se në Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Në këto vende, mund të vërehet një lidhje e fortë midis huliganëve të futbollit dhe krimit të organizuar dhe strukturave të caktuara politike, me ç'rast ideologjia shërben si mbulesë për aktivitetet kriminale fitimprurëse.

1.2. Huliganët e futbollit: Strategjitë e rekrutimit dhe ndikimi i nacionalizmit

Rekrutimi për grupet e huliganëve në Ballkanin Perëndimor kryhet me ndihmën e: krimit, lidhjeve politike dhe manipulimit të rinjve.

Rekrutimi në grupet e huliganëve është i lidhur ngushtë me preferencat partiake në **Maqedoninë e Veriut**. Ndikimi i politikës në klubet e futbollit është evident sepse çdo komunë ka përfaqësuesit e saj në klube. Kështu, politika ushtron ndikimin e saj në klube. Grupet e tifozëve në Maqedoninë e Veriut shpesh shihen si "ushtri" partiake që gëzojnë mbrojtjen e disa politikanëve, duke treguar një lidhje të drejtpërdrejtë midis tifozëve dhe partive politike (Musliu, 2022). Megjithëse lidhjet e qarta midis partive të mëdha politike dhe ultrasve më të dhunshëm zakonisht fshihen, fansat shpesh e konsiderojnë veten si ushtarët e vijës së parë të kauzave nacionaliste që dominojnë politikën ⁽¹³⁾.

“Dyert e pushtetit lokal, të kompanive dhe partive politike janë gjithmonë të hapura për ne” ⁽¹⁴⁾.

Përveç konflikteve përgjatë vijave etnike, konfliktet ndërmjet anëtarëve të të njëjtave grupe etnike që mbështesin klubet rivale në Maqedoninë e Veriut janë gjithashtu të shpeshta. Një shembull i mirë për këtë

⁽⁹⁾ Sash Gjorgjeviq dhe Ruggero Scaturro, [Lojëra të rrezikshme: Huliganizmi në futboll, politika dhe krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor](#), Iniciativa Globale kundër Krimit të Organizuar Transnacional, Qershor 2022, fq. 24.

⁽¹⁰⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Maqedonia e Veriut), Nr. 9.

⁽¹¹⁾ Komitët e mbështesin KF Vardarin dhe janë grupi më dominues për nga forca dhe numri i tifozëve. Përveç tyre, në Shkup janë aktivë edhe *Shvercerët* (ose Kontrabandistët) dhe ata e mbështesin KF Shkupin (i njohur për mbështetjen kryesisht nga shqiptarët). *Çkëmbarët* nga Manastiri e përkrahin KF Pelisterin, përkrahës të KF Pobeda nga Prilepi janë *Majmuni* (Majmunët), *Ajduci* (Hajdutët) e mbështesin KF Bellasicën nga Strumica, ndërsa në Ohër, *Ribari* (Peshkatarët) e mbështesin KF Ohrin 2004. Në Tetovë, ku shqiptarët e përbëjnë shumicën, janë dy klube dominuese: KF Shkëndija e mbështetur nga *Ballistët* dhe KF Teteksi i mbështetur nga *Vojvodët* (Dukët). Përveç tyre, aktive janë edhe grupet e mëposhtme të tifozëve: *Majmuni* (Majmunët) nga Prilepi, *Vojvodët* (Dukët) nga Tetova, *Pirati* (Piratët) nga Autokomanda, "City Park Boys" nga Komuna Qendër, Familja nga Komuna e Aerodromit etj.

⁽¹²⁾ boshnjakët, serbët, kroatët.

⁽¹³⁾ [Politika në futboll në Ballkan i mban huliganët afër pushtetit | Dhuna në futboll | The Guardian](#)

⁽¹⁴⁾ Deklarata e liderit 22-vjeçar të "Ballistëve", simpatizantë të klubit futbollistik Shkëndija nga Tetova, [Politika në futboll në Ballkan i mban huliganët afër pushtetit | Dhuna në futboll | The Guardian](#)

është rasti i tifozëve *Shvercerët* nga Shkupi dhe *Ballistët* nga Tetova, kryesisht shqiptarë etnikë, të cilët përleshën shpesh. Në hulumtimin e kryer në Maqedoninë e Veriut, arsyeja kryesore e përmendur për këto konflikte janë: urrejtja ndaj klubit rival (41,7%); intoleranca fetare dhe etnike (19,8%); ndikimi politik (7,5%); dhe interesi fitimprurës (5,7%) (Musliu, 2022). Në Maqedoninë e Veriut, edhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë, ka ende disa grupe tifozësh që mbështesin klubet futbolistike serbe "Cërvena Zvezda" dhe "Partizan", duke vënë në dukje faktin se rajoni është i ndërlidhur.

“Në stadium luftojmë me fjalë... Në rrugë luftojmë me grushte. Ne mbrojmë identitetin tonë kombëtar me gjakun tonë”⁽¹⁵⁾.

Mospërputhjet që janë specifike vetëm për Maqedoninë - që ato grupe tifozësh që mbështesin një klub të caktuar futbollit, në sporte të tjera (p.sh. në basketboll) mbështesin ndonjë klub tjetër, shpesh një klub rival⁽¹⁶⁾. Kjo sugjeron jo vetëm një problem identiteti, por edhe mungesë besnikërie – një cilësi e natyrshme e grupeve të tifozëve. Ky fenomen mund të jetë një tregues i interesave fitimprurëse.

Në **Serbi**, të gjitha grupet e huliganëve përdorin retorikë të ekstremit të djathtë dhe rekrutojnë adoleshentë përmes idesë së patriotizmit dhe nacionalizmit. Rekrutimi fillon në shkollën e mesme (12-15 vjeç) në nivel lokal⁽¹⁷⁾. Tifozët e moshuar 'i gjuajnë' djemtë në shkolla dhe i fusin ata në botën e huliganëve. Në fillim, ata i përdorin për detyra korrierësh⁽¹⁸⁾ dhe më vonë i fusin në krime të rënda. Të rinjtë i nënshtrohen një "akti inicimi", që do të thotë se ata duhet të kryejnë një kundërvajtje ose krim⁽¹⁹⁾. Përveç adoleshentëve të rinj, anëtarë rekrutohen edhe nga të rinj të zhgënjyer të klasës punëtore pa perspektivë për të ardhmen e tyre⁽²⁰⁾. Grupet e huliganëve janë të mbyllura, të organizuara në mënyrë rigorozë dhe kanë një hierarki të dallueshme sipas një modeli ushtarak. Përveç nacionalizmit, veprimet e promovuara nga këto grupe shpesh mbështeten nga homofobia ekstreme, ksenofobia, racizmi dhe forma të tjera të intolerancës. Informacionet e fundit tregojnë se disa huliganë kanë shkuar në frontin ukrainas si mercenarë të huaj⁽²¹⁾. Janë regjistruar gjithashtu lidhje me disa klube motoçiklistësh në Serbi⁽²²⁾.

Huliganët e futbollit në **Bosnjë dhe Hercegovinë** janë kryesisht të ndarë sipas linjave etnike, me përjashtim të Sarajevës dhe Tuzllës, të cilat kanë grupe etnikisht të përziera. Deri më tani, përplasjet më të shpeshta kanë qenë në Mostar midis *Ushtrisë së Kuqe* (KF Velezh) dhe *Ultras* (KF Zrinjski). Armiqësi e madhe është gjithashtu e pranishme midis klubeve të tifozëve nga Sarajeva, kryesisht midis tifozëve të KF Sarajevës dhe Shiroki Brijeg⁽²³⁾. Gjithashtu i dukshëm është rivaliteti i qytetit midis klubeve të futbollit Sarajevo dhe Zhelezniçar. Format e ekstremizmit të dhunshëm mund të gjenden edhe te brezat më të rinj. Në turneun e futbollit për fëmijë në Sarajevë (për fëmijë deri në moshën 15 vjeç) në janar të vitit 2023, pati dy incidente që mund të lidhen me nacionalizmin ekstrem. Së pari, djemtë nga ekipi kroat brohorisnin "Vrite serbin", dhe më pas prindërit e fëmijëve serbë që luajtën në turne u sulmuan fizikisht dhe u goditën me thikë (Danas, 2023).

⁽¹⁵⁾ Deklaratë nga një 17-vjeçar i lidhur me *Shvercerët*, [Politika në futboll në Ballkan i mban huliganët afër pushtetit | Dhuna në futboll | The Guardian](#)

⁽¹⁶⁾ Për shembull, grupi i tifozëve të *City Park Boys*, i cili mbështet klubin e basketbollit Rabotnički, njëkohësisht mbështet KF Vardarin – rivalin e madh të ish-klubit – në futboll. Nga ana tjetër, tifozët e KF Vardarit (të njohur edhe si Komitet) i mbështesin klubet e basketbollit Rabotnički dhe MZT, megjithëse shoqëria sportive Vardar ka një klub basketbolli me të njëjtin emër, te rivalët kryesorë të të cilit bëjnë pjesë KB Rabotnički dhe KB MZT.

⁽¹⁷⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Serbi), Nr. 4.

⁽¹⁸⁾ Djemtë (të miturit) pajisen me skuterë për transportin e drogës dhe më pas këto motoçikleta u dhurohen atyre si shpërblim. Burimi: Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Serbi), Nr. 4.

⁽¹⁹⁾ Kjo do të thotë se ata kanë të dhëna për sulmin ndaj një oficeri policie ose për vjedhjen e ndonjë sendi nga dyqani ose për fillimin e një zënke me tifozët e një klubi rival, etj.

⁽²⁰⁾ Jovo Bakiq, [Ekstremizmi i krahut të djathtë në Serbi](#), Friedrich -Ebert-Stiftung, Shkurt 2013.

⁽²¹⁾ Ata luftojnë në anën e Ukrainës. Burimi: Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 6.

⁽²²⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 6.

⁽²³⁾ Antagonizmi është rezultat i vrasjes së një tifozi të KF Sarajevës në vitin 2009, gjatë ndeshjes së ekipit në Shiroki Brijeg.

Një shembull i reciprocitetit të ekstremizmit (përgjatë vijave etnike): kur ngrihet një flamur për Slllobodan Praljak-un në një lojë në Hercegovinë ose një sllogan në mbështetje të Ratko Mlladiçit, si kundërveprim do të ngrihet një sllogan mbështetjeje për Sakib Mahmiljin në Sarajevë (këta persona janë të paditur për krime lufte) ⁽²⁴⁾.

Në distriktin e Bërçkos (Bosnje dhe Hercegovinë), ka grupe lokale huligane joformale të organizuara sipas parimit etnik-kombëtar. Shumica e grupeve të tifozëve në këtë distrikt nuk kanë një udhëheqës formal dhe ata kryesisht veprojnë në grupe më të vogla kur organizohen ngjarje sportive lokale. Struktura e moshës varion midis 15 dhe 40 ⁽²⁵⁾. Të identifikuar si më interesantët në kontekstin e aksionit të dhunshëm janë anëtarët e fraksionit të tifozëve të quajtur *Trt-Mrt*, të cilët i përkasin grupit të tifozëve *Grobari-Hijet*, tradicionalisht mbështetës të Partizanit nga Beogradi dhe anëtarët e grupit të tifozëve të quajtur *Kopre Nedri*, ose KND, të cilët i përkasin grupit të tifozëve *Delije*, tradicionalisht tifozë të Cërvena Zvezdës nga Beogradi, si dhe anëtarë të grupit të tifozëve *Manijaci* (Maniakët) nga Distrikti Bërçko në Bosnje dhe Hercegovinë, tradicionalisht mbështetës të KF Zhelezniçarit nga Sarajeva dhe gjithashtu pjesë e një grupi më të gjerë të "BH Fanaticos" nga kjo zonë. Grupet *Trt-Mrt*, *Kopre Nedri* dhe *Manijaci* kanë kontribuar shumë në radikalizimin e skenës së tifozëve në zonën e Distriktit të Bërçkos. Përveç sjelljes së dhunshme dhe gjuhës së urrejtjes, këto grupe janë akuzuar edhe për veprën penale të trafikimit të drogës ⁽²⁶⁾.

Për shkak të ideologjisë së nacionalizmit, tifozët e futbollit në **Shqipëri** lidhen me shqiptarët që jetojnë në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Tirana është qendra e skenës së fansave në Shqipëri. Ka dy grupe kryesore të tifozëve. I pari është grupi i krahut të majtë *Ultras Guerrillas 08-09* që e mbështet KF Partizanin. Është interesante se ata gëzojnë mbështetje nga shqiptarët në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë, si dhe në diasporë (Norvegji dhe Suedi) ⁽²⁷⁾. I dyti është *Tirona Fanatics* të cilët e mbështesin KF Tiranën. Ideologjia e tyre është e krahut të djathtë dhe mbështetet nga grupi i tifozëve *Shvercerët* (anëtarët e të cilit e mbështesin KF Shkupin) nga Maqedonia e Veriut. Lidhjet ndërmjet këtyre grupeve bazohen kryesisht në lidhjet etnike, familjare dhe gjuhësore. Kundërshtarët kryesorë të këtyre grupeve nga Tirana janë *Vllaznit Ultras* (KF Vllaznia) nga Shkodra dhe *Djemt e Detit*, të cilët e mbështesin KF Teuta nga Durrësi.

Mbështetësit e kombëtares shqiptare "Tifozat Kuq e Zi" kanë një ndikim të madh te tifozët shqiptarë në Maqedoninë e Veriut (*Ballistët*, *Shvercerët* dhe *Ilirët*), si dhe te tifozët në Kosovë* (*Plisat*, *Torcida* dhe *Shqiponjat*). Lidhjet mes grupit të tifozëve "Tifozat Kuq e Zi" nga Shqipëria dhe tifozëve shqiptarë në Kosovë ilustrohen më së miri me faktin se anëtarët e "Tifozave Kuq e Zi" i dhuruan një flamur të madh shqiptar familjes së Adem Jasharit nga Kosova*.

Tifozët shqiptarë nga Kosova janë të lidhur me dhunën dhe strukturat politike të afërta me ish-Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ⁽²⁸⁾. Nuk ka ndonjë rivalitet të madh në mesin e tifozëve shqiptarë të Kosovës, dhe ai më së shumti është i drejtuar ndaj grupeve të tjera etnike, në radhë të parë ndaj serbëve nga Kosova. Lidhja mes KF Plisat nga Prishtina me grupin e tifozëve *Zi dhe Kuq* nga Shqipëria është e dukshme në kontekstin e Shqipërisë së Madhe. Grupi i dytë dominues i tifozëve quhet *Shqiponjat* dhe anëtarët e tij e mbështesin KF Shqiponja.

Në vitin 2005, në Prishtinë, anëtarët e grupeve shqiptare të tifozëve *Plisat* dhe *Shqiponjat* ishin protestuesit kryesorë në një tubim të organizuar kundër krijimit të Asociacionit të Komunave Serbe dhe për vijën e demarkacionit me Malin e Zi (Mejdini dhe të tjerët, 2023).

⁽²⁴⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i komunitetit akademik (Serbi), Nr. 5.

⁽²⁵⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 7.

⁽²⁶⁾ Po aty.

⁽²⁷⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Serbi), Nr. 4.

⁽²⁸⁾ Ushtria Çlirimtare e Kosovës fillimisht u perceptua si një organizatë terroriste në shumë vende, duke përfshirë SHBA-të, <https://irp.fas.org/world/para/docs/fr033199.htm>

Popullsia etnike serbe në Kosovë tradicionalisht mbështet klubet e lidhura me Serbinë, veçanërisht Cërvena Zvezdën, dhe tregon armiqësi ndaj klubeve të lidhura me shqiptarët ⁽²⁹⁾.

Në **Malin e Zi**, është e mundur të lidhet ekstremizmi i dhunshëm me ngjarjet sportive dhe politike ⁽³⁰⁾. Futboli (dhe më rrallë basketbolli) është sporti më i instrumentalizuar nga të gjitha sportet për propagandë politike. Përkatësia etnike e një personi është përcaktuesi kryesor i lidhjes së tyre me një klub të caktuar sportiv. Malazetët mbështesin klubet e tyre kombëtare, ndërsa popullata serbe kryesisht mbështet klubet me bazë në Serbi, si Cërvena Zvezdën dhe Partizanin. Në Pllavë dhe Rozhajë, të populluara kryesisht nga boshnjakë etnikë, grupet e tifozëve *Gazije* dhe *Hajvani* mbështesin klubet lokale. Është interesante që këto klube boshnjake mbështesin 'vëllezërit e tyre' në Bosnje dhe Hercegovinë dhe kështu ata i mbështesin "BH Fanatics" në ndeshjet e futbollit. Në veri të Malit të Zi (Plevlje, Zhabljak, Mojkovac, Savnik, Pluzhine), pjesa më e madhe e popullsisë mbështet klubet serbe Cërvena Zvezdën dhe Partizanin. Në Berane dhe Bijelo Polje, përveç klubeve serbe, janë të njohura edhe grupet e tifozëve *Ultras Bijelo Polje*, aktivitetet e të cilëve kanë rënë në vitet e fundit, dhe *Street Boys Berane*. Në Nikshiq, *Vojvode* (Dukët) mbështesin KF Sutjeskën. Ka edhe mbështetës të KF Partizanit, *Grobari*, të cilët janë grupi dominues. Numri i tifozëve të KF Cërvena Zvezdës është në rënie, veçanërisht pasi flamuri i tyre u vodh disa vite më parë. *Cetinje* mbështet klubet lokale si KF Lovçen. Në qytetet bregdetare dominojnë klubet serbe, ndërsa ato që i mbështesin klubet kroate, si KF Hajduk, mund të gjenden edhe në Tivat. Në Ulqin, që është i populluar kryesisht nga pakica kombëtare shqiptare, ekziston grupi i tifozëve *Dilberët*. Në Podgoricë, grupi *Varvari* (Barbarët), anëtarët e të cilit e mbështesin KF Budućnostin, është padyshim dominues. Ata shpesh përplasen me mbështetësit e Cërvena Zvezdës.

Megjithëse huliganizmi tradicionalisht dhe kryesisht lidhet me burrat, vajzat dhe gratë, në disa raste, mund të luajnë, një rol në sfond si "aktiviste, luftëtare rrugësh dhe drejtuese të degëve lokale, koordinatore protestash dhe aktiviste në internet" ⁽³¹⁾.

1.3 Huliganizmi në futboll, krimi i organizuar dhe politika

Në Ballkanin Perëndimor ekziston një lidhje mes huliganizmit në futboll, krimin të organizuar dhe politikës. Kjo lidhje e vështirëson shumë procesin e demokratizimit në rajon.

Në **Serbi**, tifozët e Partizanit kanë një konflikt të brendshëm të kahershëm (kryesisht për shkak të ndarjes së sferave kriminale të ndikimit), siç dëshmohet nga antagonizmi mes grupeve *Zabranjeni* (Të ndaluarit) dhe *Alkatraz*. Situata në Serbi është alarmante, sepse disa grupe të tifozëve janë të lidhura me krime të rënda. Një shembull i mirë është grupi *Janjičari* (Jeniçerët) që e mbështet KF Partizanin (i cili pas një kohe u shndërrua në grupin e quajtur *Principi* (Parimet)). Udhëheqësi i tyre, Veljko Belivuk, dhe bashkëpunëtorët e tij u arrestuan para do kohësh dhe, sipas raportimeve të mediave, ishin të lidhur me disa figura të larta politike dhe anëtarë të sektorit të sigurisë (Gjorgjeviq & Scaturro, 2022, fq. 17). Grupi *Principi* akuzohet se ka bashkëpunuar me klanin malazet të Kavaçit, i 'specializuar' në trafikun e kokainës nga Amerika Latine në Evropë. Veljko Belivuk u arrestua në vitin 2021, së bashku me 20 bashkëpunëtorë të tij. Grupi u akuzua për disa vepra penale: bashkim për kryerjen e veprës penale, prodhim dhe trafikim i paautorizuar i lëndëve narkotike dhe tre raste të vrasjeve të shkallës së parë (Gjykata e Lartë e Beogradit, "Urdhërohet paraburgimi"). Pas arrestimit të klanit Belivuk, grupet *Vandal Boys* dhe *Grobari* (Varmihësit) *Vračar* u përplasën. Grupet e huliganëve të Partizanit janë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të sigurisë në klubet e natës ⁽³²⁾, tregtimin e narkotikëve dhe shantazhe ⁽³³⁾. Nga ana tjetër, ndër aktivitetet kriminale të kryera nga tifozët e Cërvena Zvezdës, janë pastrimi i parave përmes punimeve të ndërtimit, kontrolli i burimeve të energjisë, ndikimi në sektorin e TI-së dhe trafiku i drogës ⁽³⁴⁾.

⁽²⁹⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Maqedonia e Veriut), Nr. 10.

⁽³⁰⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Mali i Zi), Nr. 11.

⁽³¹⁾ [PAVE_870769_D5.1_publication_layout.pdf](https://pave-project.eu/publication/PAVE_870769_D5.1_publication_layout.pdf) (pave-project.eu)

⁽³²⁾ Një rregull i pashkruar është se ata që e kontrollojnë sigurinë e klubeve të natës e kontrollojnë edhe tregtinë e drogës.

⁽³³⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 8.

⁽³⁴⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 3.

Sot, huliganët e futbollit serb janë grupe të rënda kriminale të lidhura me individë nga politika e lartë dhe sektori i sigurisë, gjë që u jep atyre një ndjenjë pushteti dhe paprekshmërie ⁽³⁵⁾.

Disa grupe huliganësh në Serbi janë të lidhura shumë ngushtë me grupet kriminale në Mal të Zi.

Përveç huliganëve të Cërvena Zvezdës dhe Partizanit, ka edhe grupe të tjera që veprojnë në Serbi që mund të lidhen me krimin dhe ekstremizmin, duke përfshirë *United Force* (KF Rad), *Firma* (KF Vojvodina) dhe *Torcida Sanxhak* (KF Novi Pazar). Për shkak të popullaritetit të tyre të madh në të gjithë ish-Jugosllavinë, degët e Cërvena Zvezdës dhe Partizanit mund të gjenden në Bosnje dhe Hercegovinë (Republika Serbe), Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut. Përveç futbollit, huliganizmi vërehet pjesërisht edhe në basketboll dhe herë pas here në hendboll, kryesisht i reflektuar në mesazhet e gjuhës së urrejtjes.

Gjyqtarët, prokurorët dhe politikanët janë shpesh anëtarë të kryesive të klubeve sportive në Serbi — ky është një problem i madh pasi shpesh çon në konflikt interesi ⁽³⁶⁾.

Një problem i veçantë në Serbi për sa i përket parandalimit të huliganizmit është se këshillat drejtuese të disa klubeve sportive përfshijnë gjyqtarë dhe prokurorë, gjë që mund të ndikojë në objektivitetin e tyre në ndjekjen penale të personave që shkelin ligjin ⁽³⁷⁾.

Trafiku i drogës është një lloj krimi i organizuar shumë i popullarizuar në mesin e grupeve të huliganëve. Ekzistojnë rrjete rajonale për shpërndarjen e drogës në **Bosnje dhe Hercegovinë**. Huliganët nga Banja Luka dhe Sarajeva Lindore, për shembull, janë të lidhur me grupe nga Serbia dhe Mali i Zi. *Lešinari* (Shkabat), *Horde Zla* (Hordhitë e liga) dhe *Skripari* nga Bosnja dhe Hercegovina janë gjithashtu të përfshirë në tregtinë e narkotikëve dhe armëve (Gjorgjeviq & Scaturro, 2022, fq. 28).

Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, politizimi i huliganizmit në futboll (dhe lidhjet me krimin) është kryesisht i dukshëm në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Serbi. Në këto vende, huliganët përdoren për përballje me kundërshtarët politikë dhe për të përcjellë mesazhe politike ⁽³⁸⁾.

Përveç ndikimit politik, huliganët në **Maqedoninë e Veriut** janë gjithashtu të lidhur me botën e krimit. *Shvercerët* dhe *Komitët* janë të përfshirë në tregtinë e drogës dhe të armëve, gjë që i ndihmon ata të financojnë aktivitetet e tyre të tjera (Musliu, 2022, fq. 28).

Në **Shqipëri**, lidhjet midis sportit dhe ekstremizmit të dhunshëm mund të gjenden në futboll. Huliganizmi në futboll në Shqipëri në thelb përfshin dhunën mes grupeve rivale, por ka edhe konotacion politik, siç dëshmohet nga ndeshja ndërmjet ekipeve kombëtare të Serbisë dhe Shqipërisë në vitin 2014, të zhvilluar në Beograd. Në këtë ndeshje, Olsi Rama, vëllai i kryeministrit shqiptar Edi Rama, u akuzua se kishte fluturuar një dron me flamurin e Shqipërisë së Madhe, gjë që krijoi tension shtesë mes dy vendeve (CNN, 2023).

⁽³⁵⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Serbi), Nr. 4.

⁽³⁶⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Serbi), Nr. 4.

⁽³⁷⁾ Intervistë e detajuar – ish-futbollist (Serbi), nr 12.

⁽³⁸⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i një OJQ-je (Serbi), Nr. 4.

Grupet e tifozëve në Shqipëri janë të lidhura me grupet e tifozëve në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, veçanërisht kur bëhet fjalë për idenë e Shqipërisë së Madhe.

2. Ekstremizmi islamik dhe sporti

Në kohën e largimeve të para të LHT-ve që shkonin për në Siri dhe Irak, lulëzuan diskutimet mbi marrëdhëniet midis EI-së dhe sportit: disa pretenduan se ndryshimi në shprehjet sportive (veçanërisht abstenimi prej tij) mund të ishte një shenjë për radikalizimin sipas rregullave të rrepta vehabiste, ndërsa të tjerët theksuan se disa disiplina, të tilla si artet marciale, mund të përdoren për t'u përgatitur për luftëtarë.

Disa hulumtime tregojnë se "fenomeni i rekrutimit nuk është i dukshëm vetëm në futboll, por gjithashtu, për shembull, në artet e përziera marciale" (RNR, 2019, f. 3). Përderisa në vendet e Evropës Perëndimore klubet e arteve marciale janë të lidhura kryesisht me EDhKD-në, në Ballkanin Perëndimor ekziston një lidhje e fortë midis klubeve të arteve marciale dhe EI-së.

Një problem i veçantë sigurie për Bosnje-Hercegovinën janë klubet e arteve marciale⁽³⁹⁾ dhe klubet Airsoft⁽⁴⁰⁾, të menaxhuara shpesh nga individë të radikalizuar⁽⁴¹⁾. Klubet Airsoft janë gjithnjë e më të njohura në Federatën e Bosnje-Hercegovinës dhe në Distriktin Bërçko. Këtu, është e mundur të shihet lidhja e drejtpërdrejtë midis EI-së dhe sportit⁽⁴²⁾.

Klubet e arteve marciale në Federatën e BdeH organizojnë kampe për fëmijë, ku fëmijëve u mësohen doktrinat fetare dhe aftësitë ushtarake. Klubi Dimëror Askeri 2018, ku të trajnuarit ishin djem të moshës 9 deri në 17 vjeç, u organizua në komunën e Teshanjit, duke tërhequr vëmendje të madhe mediatike në të gjithë Bosnje dhe Hercegovinën dhe zemërim në Republikën Serbe (RTRS, 2023).

Përveç klubeve të arteve marciale, klubet airsoft kanë qenë veçanërisht të popullarizuara në Bosnje dhe Hercegovinë në 10 vitet e fundit. Zgjerimi i klubeve airsoft filloi rreth 10 vjet më parë, veçanërisht në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës, ku aktualisht ka më shumë se 40 klube të tilla⁽⁴³⁾. Në këto klube kryhen stërvitje ushtarake, të cilat përveç funksionit rekreativ kanë edhe atë fetar, duke i futur idetë ekstremiste islamike në aktivitetet e klubeve. Mund të vërehet se shumica e anëtarëve të klubeve airsoft i përkasin komunitetit vehabist. Është interesante se shumica e ushtrimeve të tyre kryhen në fshatrat e braktisura nga popullata serbe, ku pronat e shkatërruara nga lufta përdoren për stërvitjet e tyre. Midis anëtarëve të klubeve airsoft ka edhe anëtarë të Forcave të Armatosura të BdeH⁽⁴⁴⁾. Ato financohen përmes donacioneve, pagesave të anëtarësisë dhe sponsorizimeve. Është vërejtur se disa komunitete lokale shpesh i mbështesin klubet airsoft, në veçanti komunat e Buzhimit dhe Cazinit, por edhe komunat nga zona e Kantonit të Tuzllës. Veçanërisht të shquara janë *Crna munja*⁽⁴⁵⁾ (Rrufeja e zezë) dhe *Lilium Bosniacum*. Shumica e klubeve airsoft janë të grumbulluara në tre rajone: Rajonet Una-Sana, Zenicë-Tuzllë dhe Sarajevë. Funksionimi i këtyre klubeve shpesh monitorohet nga anëtarët e EUFOR-it⁽⁴⁶⁾. Këto klube karakterizohen me një disiplinë rigorozë dhe një theks në zinxhirin vertikal të komandës, duke i bërë ato të kenë nivel të ngjashëm të organizimit me atë të njësive speciale moderne.

⁽³⁹⁾ Aktualisht janë rreth 10 klube të tilla që mund të lidhen me ekstremizmin islamik dhe ato ndodhen në Sarajevë, Tuzllë, Bugojno, Mostar, Zenicë etj. Ato janë kryesisht taekwondo, kikkoks dhe hapkido.

⁽⁴⁰⁾ Airsoft është një sport ekstrem. Këto klube zhvillojnë trajnime për përdorimin e armëve, mjeteve shpërthyesë të minave dhe taktikave ushtarake-policore në terren sipas standardeve të njësive speciale. Në Federatën e BdeH, klubet airsoft janë të regjistruara si shoqata sportive.

⁽⁴¹⁾ Disa trajnerë ose pronarë klubesh janë anëtarë të grupeve radikale vehabiste. Disa prej tyre madje ishin anëtarë të skuadrës El Muxhahid gjatë luftës në Bosnje dhe Hercegovinë.

⁽⁴²⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 2.

⁽⁴³⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 1.

⁽⁴⁴⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 2.

⁽⁴⁵⁾ Ky klub ka një numër të madh ndjekësish në rrjetet sociale (Facebook), dhe në postimet e tyre ata lavdërojnë flamujt e luftës, simbolet dhe arrijtjet e ish-Ushtrisë së BdeH në rajonin e Bihaqit. Komentet përbajnë gjuhë eksplicite të urrejtjes drejtuar komunitetit serb.

⁽⁴⁶⁾ Intervistë e detajuar – anëtar i sektorit të sigurisë (Serbi), Nr. 2.

Në **Malin e Zi**, lidhja e krijuar nga disa klube të arteve marciale nga Bosnja dhe Hercegovina me banorët lokalë në zonat e Malit të Zi të populluara kryesisht nga popullata muslimane është evidente. Kështu, para disa vitesh përfaqësues të klubit të arteve marciale nga Tuzlla vizituan komunitetin vehabist në Pllavë dhe Gusi. Në mesin e delegacionit të Bosnjë-Hercegovinës ishte edhe Abdusamed Bushatliq, i famshëm për predikimet e tij fetare në rrjetet sociale, të cilat janë të njohura në mbarë botën.

Përfundimi

Një tipar i përbashkët i të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor është se futbollit është sporti më i lidhur me EKD-në. Kjo është veçanërisht e vërtetë për Bosnjën dhe Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, vendet në të cilat huliganët janë të lidhur me struktura kriminale dhe me struktura të caktuara politike, një fenomen i quajtur "politizimi i huliganizmit".

Një tendencë e saposhfaqur në Ballkanin Perëndimor është përdorimi i klubeve të arteve marciale dhe klubeve airsoft për indoktrinimin dhe rekrutimin e ekstremistëve të rinj. Ky fenomen është karakteristik për Bosnje dhe Hercegovinën (kryesisht për Federatën e BdeH) dhe lidhet me EI-në⁽⁴⁷⁾. Rrezik i veçantë qëndron në radikalizimin e fëmijëve të indoktrinuar në kampe me pretekstin e të mësuarit të aftësive sportive.

Viktima veçanërisht të ndjeshme të radikalizimit janë të rinjtë (adoleshentët) sepse huliganizmi është kryesisht një 'fenomen mashkullor' në Ballkanin Perëndimor (Gjoriq, 2012). E njëjta gjë vlen edhe për klubet e arteve marciale.

Sporti ka dy fytyra: e para është afirmative dhe mund të eliminojë dhunën dhe idetë ekstremiste midis popullatës së re përmes frymës ekipore dhe lojës së ndershme; fytyra e tij e dytë, më e shëmtuar, është fatkeqësisht më e dukshme në Ballkanin Perëndimor – abuzimi i sportit për radikalizimin e të rinjve. "Të mësuarit përmes lojës (siç janë sportet) mund t'i motivojë të rinjtë të ndjekin dhe të marrin pjesë në klasë ose në aktivitete rinore" (RNR, 2021, fq. 5). Ky është përfundimi nga takimi online i RNR-së në vitin 2021, i cili mund të zbatohet edhe në Ballkanin Perëndimor.

Nuk ka një strukturë të përshtatshme për parandalimin dhe kundërvënien e aktorëve të ekstremizmit të dhunshëm në fushat e lidhura me sportin për sa i përket parandalimit – këtu ka aktualisht një boshllëk dhe duhet punuar për të. Parandalimi⁽⁴⁸⁾ i këtij fenomeni duhet të trajtohet si çështje prioritare, me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar, pasi mund të ketë implikime afatgjata të sigurisë për të gjithë rajonin.

Rekomandime

- **Për institucionet shtetërore:** Zbatimi konsekuent i ligjeve — megjithëse ekzistojnë ligje relativisht të mira për parandalimin e dhunës në ngjarje sportive, ato nuk zbatohen; miratimi i strategjive shtetërore për parandalimin e dhunës në sport, pasi ato kanë skaduar në disa vende; bashkëpunimi me komunitetin akademik, shoqërinë civile dhe komunitetin ndërkombëtar për masat parandaluese (që synojnë të rinjtë dhe adoleshentët); rritja e monitorimit të komunikimeve mes ekstremistëve në kontekstin e sportit në rrjetet sociale, pasi shumica e komunikimit zhvillohet në këtë nivel; shkëmbimi i përvojave dhe informacioneve në nivel rajonal.
- **Për politikëbërësit në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar:** Në të kaluarën, Bashkimi i Shoqatave Evropiane të Futbollit (UEFA) ka reaguar ndaj formave të racizmit brenda stadumeve duke mbyllur seksionet e caktuara për tifozët vendas, duke anuluar ndeshjet ose duke skualifikuar

⁽⁴⁷⁾ Ata janë kryesisht të lidhur me komunitetet vehabiste. Është interesante se në Evropë dhe në mbarë botën, EKD-ja është e lidhur kryesisht me artet marciale.

⁽⁴⁸⁾ Rreth parandalimit të ekstremizmit në shkollat në Ballkanin Perëndimor, shih: Gjoriq, Marija. *Doracak për njohjen, parandalimin dhe luftimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm mes nxënësve* (Priručnik za prepoznavanje, prevenciju i suzbijanje radikalizacije i nasilnog ekstremizma kod učenika). Podgoricë: Byroja e Koordinimit Operativ - Ekipi Kombëtar Operativ, 2020.

ekipet e futbollit nga Liga e Kampionëve dhe Liga e Evropës (gjegjësisht KF Partizanin e Beogradit) ⁽⁴⁹⁾. Këto masa i lënë tifozët pa një hapësirë të dedikuar për aktivitete sportive dhe mund të nxisin pakënaqësi dhe ndjenja të padrejtësisë dhe diskriminimit. Duhet të vendosen kundërmasa të përshtatura, si krijimi dhe promovimi i hapësirave alternative për grumbullim në nivel lokal, për të shmangur situatat që ndalimet dhe kufizimet të rrisin tensionet në shoqëri.

- **Për klubet sportive:** Përmirësimi i qeverisjes së mirë duke eliminuar politikën nga sporti dhe duke ndaluar abuzimin e pozitës nga gjyqtarët dhe prokurorët në këshillat drejtuese të klubeve sportive; aktivitete të përbashkëta (aksione humanitare, ndeshje miqësore, etj.) të klubeve rivale me qëllim të promovimit të tolerancës; në bashkëpunim me sponsorët, promovimi i miqësisë dhe tolerancës; trajnimi i punonjësve të sportit se si t'u qasen fëmijëve dhe të rinjve (përmes punëtorive, manualeve, mjeteve të synuara) si masë parandaluese kryesore; privatizimi i klubeve (duke siguruar mekanizmat e duhur të kontrollit për të adresuar sfidat që vijnë nga privatizimi).
- **Për shoqërinë civile dhe komunitetin akademik:** Kryerja e hulumtimeve mbi lidhjet midis sportit dhe huliganizmit, pasi ka një hendek serioz në Ballkanin Perëndimor në këtë fushë; organizimi i punëtorive përmes lojërave dhe argëtimit për të rinjtë; krijimi i një rrjeti rajonal studiuesish për të trajtuar këtë temë përmes konferencave dhe projekteve; të mësuarit përmes lojës (p.sh. përmes sportit) mund t'i motivojë të rinjtë të kapërcejnë ndarjet etnike dhe ekstremizmin e dhunshëm.
- **Për komunitetin ndërkombëtar:** Organizimi i hulumtimeve rajonale, veçanërisht në temën e klubeve të arteve marciale; drejtimi i projekteve drejt parandalimit të ekstremizmit në sport; zbatimi i praktikave më të mira të huaja në rajonin e Ballkanit Perëndimor (të përshtatura për nevojat e shteteve/teritoreve të veçanta); organizimi i shkollave verore dhe punëtorive për të gjithë aktorët e këtij procesi, në mënyrë që të krijohet një rrjet rajonal për parandalimin.

Për autoren:

Marija Gjoriq është profesoreshë e rregullt e Shkencave Politike në Serbi, Beograd. Ajo është konsulente/eksperte për disa organizata ndërkombëtare (OKB, OSBE, Këshilli i Evropës, RESOLVE, ndër të tjera). Profesoresha Gjoriq ka botuar pesë libra dhe më shumë se 90 punime mbi ekstremizmin, radikalizimin, huliganizmin, terrorizmin dhe dhunën politike. Ajo është kryeredaktore e revistës akademike serbe Politika e Sigurisë Kombëtare. Ajo aktualisht punon në Institutin për Studime Politike në Beograd dhe është profesoreshë vizitore në Universitetin Charles në Pragë.

⁽⁴⁹⁾ [Përgjigjia ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor. \(nyu.edu\)](http://nyu.edu)

Bibliografia

- AFRODITA MUSLIU, *ИДЕНТИФИКАЦИЈА НА ФАКТОРИ КОИ ВЛИЈААТ ВРЗ НАСИЛСТВОТО НА СПОРТСКИ ТЕРЕНИ [IDENTIFICATION OF FACTORS INFLUENCING VIOLENCE ON SPORT FIELDS]*, SKOPJE: ASSOCIATION OF CITIZENS "NEXUS – CIVIL CONCEPT", 2022.
- ANDRIC, GORDANA AND BOJANA BARLOVAC, BELGRADE RIOTS OVER, OFFICIALS CONDEMN VIOLENCE, BALKAN INSIGHT, 10 OCTOBER 2010. ACCESSED 22 JUNE 2023, [HTTPS://BALKANINSIGHT.COM/2010/10/10/SITUATION-IN-BELGRADE-CALMS-DOWN-AFTER-CLASHES/](https://balkaninsight.com/2010/10/10/situation-in-belgrade-calms-down-after-clashes/)
- BAKIC JOVO, RIGHT-WING EXTREMISM IN SERBIA, FRIEDRICH-EBERT-STIFTUNG, FEBRUARY 2013. ACCESSED 22 JUNE 2023, [HTTPS://LIBRARY.FES.DE/PDF-FILES/ID-MOE/09659.PDF](https://library.fes.de/pdf-files/id-moe/09659.pdf)
- CHUA SHENYI ET AL., RESPONDING TO VIOLENT EXTREMISM IN THE WESTERN BALKANS, CENTER FOR GLOBAL AFFAIRS SCHOOL OF PROFESSIONAL STUDIES, NEW YORK UNIVERSITY, 20 MAY 2020.
- CNN, BROTHER OF ALBANIAN PRIME MINISTER 'CONTROLLED' DRONE AT FOOTBALL MATCH, 15 OCTOBER 2014. ACCESSED 5 JANUARY 2023, [HTTPS://EDITION.CNN.COM/2014/10/15/SPORT/FOOTBALL/ALBANIA-PRIME-MINISTER-BROTHER/INDEX.HTML](https://edition.cnn.com/2014/10/15/sport/football/albania-prime-minister-brother/index.html)
- DANAS, MLADI FUDBALERI IZ SPLITA ISKLJUČENI SA TAKMIČENJA U SARAJEVU ZBOG SKANDIRANJA 'UBIJ, UBIJ SRBINA', 15 JANUARY 2023. ACCESSED 20 JANUARY 2023, [HTTPS://WWW.DANAS.RS/SVET/REGION/MLADI-FUDBALERI-IZ-SPLITA-ISKLJUCENI-SA-TAKMICENJA-U-SARAJEVU-ZBOG-SKANDIRANJA-UBIJ-UBIJ-SRBINA/](https://www.danas.rs/svet/region/mladi-fudbaleri-iz-splita-iskljuceni-sa-takmicenja-u-sarajevu-zbog-skandiranja-ubij-ubij-srbina/)
- DARIO BRENTIN, MORE THAN A GAME? AGAIN? ON THE SEEMINGLY PERPETUAL FOOTBALL-RELATED VIOLENCE IN THE BALKANS, BALKANIST, 15 OCTOBER 2014. ACCESSED 15 JANUARY 2023, [HTTPS://BALKANIST.NET/MORE-THAN-A-GAME-AGAIN-ON-THE-SEEMINGLY-PERPETUAL-FOOTBALL-RELATED-VIOLENCE-IN-THE-BALKANS/](https://balkanist.net/more-than-a-game-again-on-the-seemingly-perpetual-football-related-violence-in-the-balkans/)
- DORĐEVIĆ, SAŠA AND RUGGERO SCATURRO, DANGEROUS GAMES: FOOTBALL HOOLIGANISM, POLITICS AND ORGANISED CRIME IN THE WESTERN BALKANS, GENEVA: GLOBAL INITIATIVE AGAINST TRANSNATIONAL ORGANISED CRIME, 2022.
- ĐORIĆ, MARIJA AND KLAČAR BOJAN, POTENTIAL GENERATORS OF RIGHT-WING EXTREMISM IN THE ERA OF COVID-19 PANDEMIC (WHITE PAPER-PREVIEW), SARAJEVO: IRI, 2021.
- FATJONA MEJDINI ET AL., KOSOVO OPPOSITION URGES ALL ALBANIANS TO JOIN RALLY, BALKAN INSIGHT, 27 NOVEMBER 2015. ACCESSED 12 JANUARY 2023, [HTTPS://BALKANINSIGHT.COM/2015/11/27/ALBANIANS-JOIN-RANKS-FOR-THE-28-NOVEMBER-KOSOVO-RALLY-11-27-2015-1/](https://balkaninsight.com/2015/11/27/albanians-join-ranks-for-the-28-november-kosovo-rally-11-27-2015-1/)
- ILAZI RAMADAN ET AL., ONLINE AND OFFLINE (DE)RADICALISATION IN THE BALKANS, WORKING PAPER 5, PAVE PROJECT PUBLICATIONS, 2022.
- MANASIEV ALEKSANDAR, BALKANS' POLITICAL FOOTBALL KEEPS HOOLIGANS CLOSE TO HEART OF POWER, THE GUARDIAN, 29 NOVEMBER 2012. ACCESSED 22 JUNE 2023, [HTTPS://WWW.THEGUARDIAN.COM/FOOTBALL/2012/NOV/29/BALKANS-POLITICAL-FOOTBALL-HOOLIGANS-POWER](https://www.theguardian.com/football/2012/nov/29/balkans-political-football-hooligans-power)
- MARIJA ĐORIĆ, THE EVOLUTION OF HOOLIGANISM IN SERBIA, SCIENCE AND SOCIETY, No 2, 2014.
- MARIJA ĐORIĆ, HULIGANIZAM: NASILJE I SPORT, BEOGRAD: NAUKA I DRUŠTVO, 2012.
- MARIJA ĐORIĆ, HANDBOOK FOR RECOGNIZING, PREVENTING AND COMBATING RADICALIZATION AND VIOLENT EXTREMISM AMONG STUDENTS (PRIRUČNIK ZA PREPOZNAVANJE, PREVENCIJU I SUZBIJANJE RADIKALIZACIJE I NASILNOG EKSTREMIZMA KOD UČENIKA), PODGORICA: BIRO ZA OPERATIVNU KOORDINACIJU – NACIONALNI OPERATIVNI TIM, 2020.
- METODIEVA ASYA, DOVEDIMO IH NAZAD: UPRAVLJANJE RIZIKOM, SARAJEVO: ATLANTSKA INICIJATIVA, MAY 2021. [HTTPS://ATLANTSKAINICIJATIVA.ORG/WP-CONTENT/UPLOADS/2021/05/POLICY-PAPER-BR.-1-BOS.PDF](https://atlantskainicijativa.org/wp-content/uploads/2021/05/policy-paper-br.-1-bos.pdf)
- RAN, THE ROLE OF SPORTS AND LEISURE ACTIVITIES IN PREVENTING AND COUNTERING VIOLENT EXTREMISM, 2019. ACCESSED 15 MARCH 2023, [HTTPS://HOME-AFFAIRS.EC.EUROPA.EU/SYSTEM/FILES/2019-05/RAN_YFC_SPORTS_AND_LEISURE_06-07_03_2019_EN.PDF](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2019-05/ran_yfc_sports_and_leisure_06-07_03_2019_en.pdf)
- RAN, INCLUSION THROUGH SPORTS, 2021. ACCESSED 15 MARCH 2023, [HTTPS://HOME-AFFAIRS.EC.EUROPA.EU/SYSTEM/FILES/2022-01/RAN_Y-E_INCLUSION_THROUGH_SPORTS_01122021_EN.PDF](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2022-01/ran_y-e_inclusion_through_sports_01122021_en.pdf)

RTRS, "ASKER AKADEMIJA" U BIH, DECA U SIMULACIJI VOJNE OBUKE, 8 FEBRUARY 2018. ACCESSED 5 JANUARY 2023, [HTTPS://WWW.RTS.RS/PAGE/STORIES/SR/STORY/11/REGION/3032595/ASKER-AKADEMIJA-U-BIH-DECA-U-SIMULACIJI-VOJNE-OBUKE.HTML](https://www.rts.rs/page/stories/sr/story/11/region/3032595/asker-akademija-u-bih-deca-u-simulaciji-vojne-obuke.html)

ALBERTO TESTA, MAKING SENSE OF EXTREMISM IN THE BOSNIAN FOOTBALL TERRACES: AN INITIAL ANALYSIS, SECURITY SCIENCE JOURNAL, NO. 1 (2020). [HTTPS://DOI.ORG/10.37458/SSJ.1.1.2](https://doi.org/10.37458/ssj.1.1.2)

VIŠI SUD U BEOGRADU, ODREĐEN PRITVOR OSUMNJIČENIMA V. BELIVUK I DRUGI, 6 FEBRUARY 2021. ACCESSED 12 JANUARY 2023, [HTTPS://WWW.BG.VI.SUD.RS/VEST/2991/ODREDJEN-PRITVOR-OSUMNJCENIMA-V-BELIVUK-I-DRUGI.PHP](https://www.bg.vi.sud.rs/vest/2991/odredjen-pritvor-osumnjicenima-v-belivuk-i-drugi.php)

GJETJA E INFORMACIONIT RRETH BE-së

Online

Të dhëna lidhur me Bashkimin Evropian në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së ka në ueb-faqen e Evropës në: https://europa.eu/european-union/index_en

Publikimet e BE-së

Mund të shkarkoni ose të porositni publikime të BE-së falas dhe me pagesë nga: <https://op.europa.eu/en/publications>. Shumë kopje të publikimeve falas mund të gjenden duke kontaktuar Europe Direct ose qendrën tuaj lokale të informimit (shih https://europa.eu/european-union/contact_en).

Ligjet e BE-së dhe dokumentet përkatëse

Për qasje në të dhëna ligjore nga BE-ja, duke përfshirë të gjitha ligjet e BE-së që nga viti 1952 në të gjitha versionet në gjuhët zyrtare, shkoni në EUR-Lex në: <http://eur-lex.europa.eu>

Të dhëna të hapura nga BE-ja

Portali i të dhënave të hapura të BE-së (<http://data.europa.eu/euodp/en>) siguron qasje në grupet e të dhënave nga BE-ja. Të dhënat mund të shkarkohen dhe ripërdoren falas, për qëllime komerciale dhe jokomerciale.

Radicalisation Awareness Network

RANI

Practitioners

